

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-039/14

**Prishtinë,
16 dhjetor 2015**

Në çështjen juridike të

B.B.

Lazara Lopičića 19/1
Kraljevë, Serbi

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

D.B.

Tirana 13
Gjakovë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me Ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA40552 dhe KPA40553), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 16 dhjetor 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga B.B. , të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-39/2014 dhe GSK-KPA-A-040/2014, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-039/2014.
2. Refuzohen si të pabazuara Ankesat e paraqitura nga B.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA40552 dhe KPA40553.
3. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013 i datës 13 shkurt 2013, sa i përket Kërkesave nr. KPA40552 dhe KPA40553.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 21 maj 2007, B.B. (në tekstin e mëtejshëm: Pala ankuese) ka paraqitur dy Kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të regjistruara me numër të lëndës KPA40552 dhe me numër KPA40553, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale 1297/1, me sipërfaqe prej 1.83.74 ha dhe ngastrës kadastrale 1298/2 me sipërfaqe prej 0.80.66 ha, në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar), dhe ka kërkuar kompensim për shfrytëzimin e pronës së kërkuar pa pëlqimin e tij.
2. Së bashku me Kërkesën ai *inter alia* ka dorëzuar në AKP:
 - Kopjen e Fletës Poseduese Nr. 96/20.02.2002 që e tregon Ankuesin si bartës i së drejtës pronësore (BDP) për 30/120 (¼) pjesë ideale të pronës së kërkuar;
 - Kopjen e planit nr.953-2/2005-486/21.12..2005, që e tregon Ankuesin si BDP të pronës së kërkuar;
 - Kontratën mbi dhurimin nr.938/1977 që tregon se Ankuesin e ka pranuar ¼ e pronës së kërkuar nga xhaxhai i tij;

Të gjitha dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.

3. Më 03 nëntor 2010, AKP-ja e ka bërë njoftimin e kërkesës. Prona u gjet e uzurpuar nga D.B. (në tekstin e mëtejshëm: Pala përgjegjëse në ankesë) i cili ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj saj dhe ka shprehur synimin e tij që të marrë pjesë në kërkesë. Pala përgjegjëse në ankesë ka pretenduar se ai i

kishte blerë ngastrat në vitin 2001 nga babai i ankuesit dhe kontrata e blerjes ishte lidhur në vitin 2004.

4. Pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar në AKP:
 - Kontratën e blerjes së pronës së paluajtshme, e lidhur më 16 nëntor 2004 në mes të Palës ankuese si shitës dhe Palës përgjegjëse në ankesë si blerës për pronën e kërkuar.
5. Ankuesi është kontaktuar më 11 janar 2013 nga AKP-ja dhe ai ka konfirmuar se pronën e kërkuar ia kishte shitur PPK-së në vitin 2001 dhe në vitin 2004 ishte lidhur kontrata e blerjes.
6. Më 13 shkurt 2013, KKPK-ja me vendimin KPCC/D/A/188/2013 i ka hedhur poshtë Kërkesat për faktin se kërkesat ishin jashtë mandatit të Komisionit pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në vitin 1998-1999 dhe për shkak të mungesës së jurisdikcionit për sa i takon kërkesave mbi kompensimin në lidhje me shfrytëzimin pa dhënjën e pëlqimit.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar Ankuesit më 15 gusht 2013. Më 27 gusht 2013, janë paraqitur ankesat nga paraqitësi i kërkesës/pala ankuese.

Pretendimet e palës ankuese

8. Në ankesë, pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve relevante. Ai gjithashtu pretendon se ai asnjëherë nuk kishte pranuar dokumente të ofruara nga Pala përgjegjëse në ankesë dhe se ai asnjëherë nuk kishte bërë ndonjë deklaratë për sa i takon humbjes së posedimit të pronës së kërkuar vullenatrisht ose për shkak të rrethanave të tjera, por ekskulzivisht për shkak të konfliktit të armatosur. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin e KKPK-së dhe ta njoh pronësinë e tij mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e Ankesave

9. Ankesat janë paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh të paraparë me Nenin 12. 1 të Ligjit nr. 03/L-079 neni 12.1 dhe është e pranueshme.

Bashkimi i ankesave

10. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 që thekson se Gjykata Supreme mund të vendos për bashkimin e ankesave, kur një bashkim i tillë i kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen lejon Gjykatën Supreme që të

merr në konsideratë bashkimin e ankesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr aktgjykime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të dëshmime.

11. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitën e nenit 408.1 lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 i Procedurës Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse një gjë e tillë do të siguronte efikasitet të lëndës në gjykatë.
12. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm me të cilin është paraqitur ankesa në fjalë, faktet, bazat ligjore dhe çështjet e dëshmime janë saktësisht të njëjta në të dy rastet. Vetëm ngastrat kadastrale, çështja lëndore e të drejtës pronësore që pretendohet në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumente të njëjta. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesa është i njëjti.
13. Prandaj, Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-039/14 dhe GSK-KPA-A-040/14, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-039/14.

Meritat e ankesës

14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, ankuesi duhet të paraqes jo vetëm titullin e pronësisë mbi një pronë të paluajtshme private por edhe të dëshmojë se ai apo ajo **tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.**
15. Sipas nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative 2007/5, ... “çdo person i cili ka pasur të drejtë të pronësisë, posedim ligjor apo çfarëdo të drejta tjetër ligjore të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale, i cili në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur...”. Kërkesat në fjalë janë paraqitur në Agjencionin Kosovar të Pronës në vitin 2007. Megjithatë, Ankuesi e ka shitur pronën e kërkuar në vitin 2001, një kontratë për blerje është lidhur në vitin 2004, dhe Ankuesi e ka konfirmuar këtë fakt. Prandaj, lënda është jashtë juridiksionit të KKPK-së, pasi që pamundësia e ushtrimit të të drejtave pronësore nuk është si rezultat i konfliktit të armatosur kur paraqitësi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në AKP.

16. KKPK-ja ka mandat të kufizuar që merret vetëm me kërkesat pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private posedimi i të cilave është humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
17. Duke lënë anash për momentin shqyrtimin e validitetit të kontratës gojore ose kontratës së shitjes për të gjithë pronën, Gjykata Supreme vjen në përfundimin se aktivitetet e përmendura nga Ankuesi provojnë faktin se ai ka humbur posedimin e pronës së kërkuar për shkak të konfliktit, meqenëse ai ka hyrë në kontratë e shitëblerjes së pronës pas luftës. Pa marrë parasysh efektet ligjore të këtyre efekteve duhe të theksohet se Ankuesi ka mundur që të dispononte me pronën pas konfliktit. Pretendimet e tija për sa i takon humbjes së posedimit gjatë konfliktit duhet të konisdrerohet si jo i besueshëm.
18. Gjykata Supreme e Kosovës dëshiron të theksoj që me qëllim që të aprovoj kërkesën dy kushte në të njëjtën duhet të plotësohen: të provohet e drejta e paraqitësit të kërkesës dhe që humbja e posedimit të jetë bërë për shkak të rrethanave që kanë ngjarë në Kosovë në mes të vitteve 1998/1999. Përmbushja e vetëm njerit kusht nga ana e epalës përjashton mundësinë e aprovimit të kërkesës.
19. Rrjedhimisht, KKPK-ja ka vepruar drejtë kur e ka konsideruar çështjen si të përjashtuar nga juridiksioni i saj. Nuk ka pasur as shkelje të së drejtës materiale apo procedurale e as vërtetim të gabuar apo jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme konstaton se Ankesa është e pabazuar.
20. Në bazë të të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3 nën c (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ky Aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e Ankuesit që t'i realizoj kërkesat e pretenduara pranë gjykatës kompetente, nëse e konsideron të domosdoshme.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it